



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë B e folur

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore në klasë, 40 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të ndihmojë studentët të zhvillojnë dhe përmirësojnë kompetencat komunikuese dhe të folurit në gjuhën frënge, duke përdorur situata të jetës së përditshme dhe shkëmbime mendimesh. Të sigurojë një mjedis të gjallë dhe ndërveprues të të nxënës, i cili inkurajon pjesëmarrjen aktive, zgjeron fjalorin dhe nxit aftësinë për të përdorur frëngjishten në mënyrë të natyrshme dhe të saktë.

Objektivat e specifike lëndore:

1. Studentët të arrijnë kompetenca funksionale të folurit, si përshkrimi, shpjegimi, komentimi dhe shprehja e mendimeve mbi tema të thjeshta të jetës së përditshme.
2. Të përvetësojnë fjalorin tematik bazë dhe strukturat sintaksore të nevojshme për të komunikuar në nivelin A1–A2 sipas Kuadrit Evropian të Përbashkët të Referencës për Gjuhët.

Rezultate e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të marrin pjesë në biseda të thjeshta në frëngjisht, të bëjnë pyetje dhe të japin përgjigje për tema të njohura.
2. Do të jenë të aftë të përshkruajnë me fjalë të tyre persona, vende dhe situata, duke përdorur fjalor të përshtatshëm dhe struktura të sakta gramatikore.